TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 824
Dt. 26.11.2026
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

Datë: 26.11.2026

Bazuar në nenin 8 te Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 01/2024 dhe plotësim ndryshimin e UA 03/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit ne sektorin publik dhe në bazë të nenit 17, paragrafi 3, pika 1 të Statutit të Kompanisë me Nr. I/02 të datës 19.01.2024, Kryeshefi Ekzekutiv shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës së punës: Punëtor i Sigurimit Fizik të Objekteve/Aseteve në Transportin e Udhëtarëve
Institucioni: Hekurudhat e Kosovës – Trainkos SH.A.
Numri i referencës: 21 – 26.11.2026.
Tipi i Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit të punës NR. 03/L-212, plotësim ndryshimi UA 01/2024 dhe UA03/2025.
Titulli i mbikëqyrësit: Shefi i Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 muaj.
Koeficienti/Paga: 500 Euro dhe shujta ditore
Procedura e aplikimit: Publik
Numri i kërkuar: 3
Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën ruajtjen dhe sigurimin e objekteve, aseteve dhe pasurisë së Trainkos-it
- Përkujdeset për siguri në trenat e udhëtarëve si dhe ndihmon konduktorët në kryerjen e punëve së tyre
- Zbulon dhe evidenton veprimet e personave që rrezikojnë jetën dhe dëmtojnë pasurinë e Trainkos-it
- Bën kapjen e personave që zihen duke kryer vjedhje apo dëmtime të pasurisë së Trainkos-it dhe është i obliguar që menjëherë të lajmërojë Shefin si dhe Policinë e Kosovës
- Merr masa për ruajtjen e gjurmëve të veprës penale si dhe ruajtjen e mjeteve me të cilat është kryer vepra penale
- Ruan të gjitha shënimet për rastet e cekura më lart (vendi i kryerjes, data, shënimet të cilat çojnë në identifikimin e kryesit të veprës penale, si dhe shënimet mbi lajmërimin e personave zyrtar të PK-së duke përfshirë: datën, orën, njësinë dhe emrin e zyrtarit të PK-së
- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative tjera si dhe sipas kërkesave nga Shefi i Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve
- Harton raporte pune të rregullta dhe periodike
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive i përgjigjet Shefit të Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të ketë të përfunduar Shkollën e Mesme
- Të posedojë aftësi të mira komunikuese dhe organizative
- Të jetë konfidencial dhe i angazhuar në kryerjen e detyrave
- Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në grup
- Preferohet të jetë i Licencuar për sigurim themelor nga institucioni përkatës
- Të jetë i gatshëm të punojë në një mjedis multi-kulturor.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/çertifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e

punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal;

- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike).Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një **vetë deklaratë** me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik ;
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit;
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak:
Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të njoftohen përmes postës elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com) duke i respektuar afatet sipas Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 03/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 01/2024 për Procedurat e Konkursit në Sektorin Publik.

Mënyra e aplikimit:
• Aplikimi është online përmes postes elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com). Aplikacionin mund ta shkarkoni nga www.Trainkos.com. Ngarkoni dokumentet sipas kërkesave ne konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuat vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri shkruani ne e-mailin (apliko.trainkos@trainkos.com) për te vërtetuar aplikim tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mail njoftues).

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:
• Përmes postës elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:
• Testimi me shkrim – deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
• Intervista – deri në njëzet (20) pikë.
• Jetë përshkrimi (CV) – deri në dhjetë (10) pikë.

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak:
• Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të njoftohen përmes postës elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com) duke i respektuar afatet sipas Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 03/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 01/2024 për Procedurat e Konkursit në Sektorin Publik.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit, ju lutemi të keni parasysh se sistemi nuk mund të pranojë email-e me madhësi më të madhe se 10 MB. Prandaj, ne nuk marrim përgjegjësi për aplikacionet që nuk mund të dorëzohen për shkak të madhësisë së tepruar. Aplikacionet që dorëzohen pas afatit, si dhe ato që janë të mangëta ose nuk përmbushin kriteret e specifikuara, do të refuzohen.

Data e aplikimit mbetet e hapur deri me datën 11.12.2026 ora 16:00
Fushë Kosovë, 26.11.2026.

Kryeshefi Ekzekutiv
Agron Statovci

TRAINKOS SH.A. • TRAINKOS • Fushë Kosovë • Kosovo Polje • 1